

Këshilli Mbikëqyrës

RREGULLORE

PER ADMINISTRIMIN E KONTRIBUTEVE DHE PERFITIMET SUPLEMENTARE TE SIGURUARVE NE INSTITUTIN AMERIKAN TE PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE

(Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.____, datë____ 2005)

Mbeshtetur ne nenin 22, pika 6, te Ligjit nr. 7943, datë 23.12.1997 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve” (i ndryshuar), si dhe ne aktet e tjera ligjore e nënligjore, të nxjerra në bazë e për zbatim të tij, Keshilli Mbikqyres i I.A.P.P.S.SH

MIRATON :

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Objekti

- 1.1 Kjo rregullore përcakton rregullat juridike dhe financiare te administrimit të fondit të pensioneve private suplementare në Institutin Amerikan të Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë
- 1.2 Në këtë rregullore përcaktohen gjithashtu edhe marrëdhëniet e të siguruarve me fondin e pensionit.
- 1.3 Kjo skemë sigurimi, është tërësia e marrëdhënieve që rregullojnë kontributin e paguar nga çdo subjekt në fondin e pensionit për efekt sigurimi, përfitimin, si dhe çdo pagesë tjetër që rrjedh nga fondi i pensionit, pervec atyre që akordohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm nëpërmjet ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Përcaktime

- 2.1 Me termin “*fond pensioni*”, do të kuptohet tërësia e mjeteve financiare të krijuara në “I.A.P.P.S.SH.” Në këtë tërësi të mjeteve financiare do të përfshihen:
 - a) tërësia e mjeteve financiare qe rrjedhin nga pagimi i kontributeve për sigurimin e çdo individi;si dhe

- b) të gjitha pagesat që akordohen nga ky fond për përfitimet e të siguruarve.
- 2.2 Me termin “*përfitim*”, kuptohet e ardhura periodike, që i paguhet çdo personi të siguruar në fondin e pensionit, për të gjitha rastet e parashikuara në këto rregulla.
- 2.3 “Termet “*pension pleqërie*”, “*pension vjetërsie ne pune*”, “*pension familjar*” do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7943, datë 01.06.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”
- 2.4 Me termin “*pension pleqërie i perhershem*” do të kuptohet ai lloj pensioni pleqërie i percaktuar në kontratë, me anë të të cilit përfituesi përfiton pension suplementar pergjate gjithë jetës së tij, duke filluar nga momenti që i lind e drejta për të përfituar.
- 2.5 Me termin “*pension pleqërie me kohë të percaktuar*” do të kuptohet ai lloj pensioni pleqërie për të cilin përfituesi percakton një shtrirje kohore gjatë së cilës ai do të përfitojë pension suplementar.
- 2.6 “*Skema e sigurimit të fondit*”, është tërësia e normave të administrimit të fondit të pensionit, të parashikuara në këto rregulla.
- 2.7 “*Administrim*” është procesi i mbledhjes dhe i regjistrimit të kontributeve, financimi, investimi apo riinvestimi, si dhe pagimi i mjeteve financiare të fondit të pensionit, sipas kushteve që përcaktohen në këto rregulla.
- 2.8 Me termin “*kontratë sigurim*”, do të kuptohet kontrata e lidhur me shkrim, e cila është një marrëveshje vullnetare, e përfunduar ndërmjet të siguruarit dhe “I.A.P.P.S.SH.”, për sigurim privat suplementar, me anë të së cilës palet marrin përsipër detyrimet e parashikuara:
- a) në ligj;
 - b) në kontratë;
 - c) dhe në këto rregulla.
- 2.9 “*I siguruar*” është çdo individ, i cili, direkt ose nëpërmjet përfaqësimit, ka përfunduar një marrëveshje me “I.A.P.P.S.SH.” për të marrë pjesë në skemën e sigurimit të këtij fondi dhe ka filluar pagesën e kontributeve sipas përcaktimit në këto rregulla. Në kuptim të këtij termi, “i siguruar” mund të jetë:
- a) çdo person që ka përfunduar një marrëveshje me “I.A.P.P.S.SH.” për të marrë pjesë në skemën e sigurimit; dhe
 - b) punëdhënësi i çdo punëmarrësi (në rastet e një kontrate aderimi) dhe / ose vetë punëmarrësi;
- me qëllim përfitimin sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
- 2.10 Me termin “*kontribut*”, do të kuptohen pagesa periodike të rregullta ose të menjehershme, në fondin e pensionit, të kryera për çdo të siguruar në llogarinë e tij, për marrjen e përfitimeve në përputhje me ligjin, me këto rregulla, si dhe sipas përcaktimeve të kontratës individuale të përfunduar me “I.A.P.P.S.SH.”.

- 2.11 Me termin “*Kontratë e aderimit*” te punedhënesit me institutin e pensioneve”, do të kuptohet kontrata që një punedhënes nënshkruan me “I.A.P.P.S.SH.” për sigurimin suplementar të të punësuarve të tij, me kushtin që të përmbushë detyrimet e vendosura në këto rregullore dhe në kontratën e aderimit.
- 2.12 “Me termin “*grante*” do të kuptohen shuma në të holla që mund t’i paguhet në mënyrë të menjëhershme çdo personi të siguruar në fond, sipas kushteve të përcaktuara në këto rregulla, si dhe në kontratën individuale të sigurimit.
- 2.13 Me termin “*shlyerje*” do të kuptohen mënyrat e kthimit të kontributeve.
- 2.14 Me termin “*Përfitime të pagueshme në formën e shumave të menjëhershme*” do të kuptohen përfitimet që sigurohen në formën e kthimit të shumave kur i siguruari përmbush kushtet për pension dhe në rastet e parashikuara në këto rregullore.

Neni 3

Fondi i pensionit i “I.A.P.P.S.SH.” dhe rastet e mbulimit me përfitime

Fondi i pensionit i “I.A.P.P.S.SH.”, ka si qëllim mbulimin me përfitime në raste të pakësimit të të ardhurave si pasojë e:

- I. pleqërisë,
- II. humbjes së jetes të të siguarit ;
- III. ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënieve të sigurimit.

Neni 4

Përdorimi i fondit të pensionit

- 4.1 Mjetet në fondin e pensionit përdoren për të paguar përfitimet që rrjedhin nga skema e sigurimit të fondit për çdo person të siguruar në “I.A.P.P.S.SH.”.
- 4.2 Mjetet në fondin e pensionit të “I.A.P.P.S.SH.” nuk transferohen, dhe as përdoren për një qëllim tjetër, të ndryshëm nga përcaktimi i nenit 3 të këtyre rregullave.
- 4.3 Nga të ardhurat që rrjedhin si pasojë e administrimit të fondit të pensioneve të “I.A.P.P.S.SH.”, kryhen financime për të përballuar shpenzimet për administrimin e fondit sipas këtyre rregullave, si dhe për pasojat të indeksimit apo të detyrimeve të tjera ligjore të pagueshme.

Neni 5

Periudhat e njohura si periudha të mbrojtjes nga sigurimi në fondin e pensionit

Periudha të mbrojtjes, si rezultat i sigurimit në fondin e pensionit, quhen të gjitha ato periudha për të cilat janë paguar kontributet.

PJESA II

FONDI I PENSIONIT

Neni 6

Elementët e fondit të pensionit dhe burimet e krijimit të tij

- 6.1 Fondi i pensionit të "I.A.P.P.S.SH." përbëhet nga dy pjesë :
- a) pjesa e fondit të përfitimeve, i cili administrohet në mënyrë që të sigurojë një pagesë të pandërprerë të përfitimeve që rrjedhin prej tij, dhe
 - b) pjesa e fondit të investueshëm, i cili administrohet nga "I.A.P.P.S.SH." për të siguruar nivele të larta investimi.
- 6.2 Burimet e krijimit të fondit të pensionit të "I.A.P.P.S.SH." janë:
- a) kontribute të të siguruarve dhe/ose të punëdhënësve;
 - b) subvencione;
 - c) të ardhura të tjera, duke përfshirë arkëtimet nga kamatëvonesat për parregullsi në pagimin e detyrimeve kontributive, si dhe dhurimet apo trashëgimitë e subjekteve (persona fizikë e juridikë) për fondin e pensionit;
 - d) të ardhurat nga administrimi i mjeteve në fondin e pensionit.

Neni 7

Garancia e fondit të pensionit

Në raste humbjesh apo pakësimesh të mjeteve financiare, të "I.A.P.P.S.SH." garanton fondin e pensionit me mjete nga fondi i saj i rezervës së përgjithshme, për mbulimin me të paktën 2 vjet shpenzime për pagimin e përfitimeve sipas skemës së sigurimit të fondit.

Neni 8

Administrimi i fondit

- 8.1 Administrimi i fondit kryhet nga organi ekzekutiv i "I.A.P.P.S.SH."
- 8.2 "I.A.P.P.S.SH." përdor mundësitë më të mira për të mbajtur fondin e pensionit në nivele të përshtatshme për zbatimin e këtyre rregullave.
- 8.3 "I.A.P.P.S.SH." kontrollohet nga kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm.
- 8.4 Përdorimi i fondit të pensionit, nëpërmjet shpërndarjes së përfitimeve, realizohet sipas skemës së sigurimit, të përcaktuar në këto rregulla.
- 8.5 Përfitimet që rrjedhin si rezultat i administrimit të fondit, do të përdoren në mënyrë ekskluzive në dobi të personave të siguruar në këtë skemë sigurimi.

Neni 9

Kontributet

- 9.1 Çdo i siguruar kryen pagesën e kontributeve në Lekë. Në rastet e pagimit të kontributeve në monedhe të huaja, do të bëhet konvertimi në leke nga Banka, me kursin e ditës në të cilin bëhet derdhja.
- 9.2 Masa konkrete e kontributit përcaktohet në çdo rast në kontratën e sigurimit, por kurdohere jo më pak se 500 (peseqind) leke në muaj.
- 9.3 Pagesat e kontributit të kryera në fondin e pensionit përgjatë vitit financiar bëhen, si rregull në çdo muaj kalendarik. Perjashtimet nga ky rregull përcaktohen në çdo rast në kontratën e sigurimit.
- 9.4 Çdo i siguruar, i cili ka nënshkruar vullnetarisht kontratën e sigurimit, paguan kontributin në fondin e pensionit, sipas përcaktimit në kontratë dhe në këto rregulla.
- 9.5 Masa individuale mujore e pageses së kontributit të personave të siguruar, paguhet në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratë.
- 9.6 I siguruari mund të kontribuojë në çdo kohë me shumën të menjehershme, të cilat bëhen pjesë e llogarise së tij individuale.
- 9.7 Në rastet kur një person i siguruar, kërkon të sigurohet edhe për periudha të kaluara, shumën e kontributeve do të llogaritet duke shumëzuar masën e kontributit të muajit të fundit kur do të bëhet pagimi i tyre, me atë muaj sa i siguruari kërkon të sigurohet.
- 9.8 Për të mbuluar me siguri edhe periudha të kaluara sipas kësaj skeme, pagimi i kontributeve do të bëhet për çdo rast, jo më pak se 5 (pesë) vjet para lindjes së të drejtës për përfitim.

PJESA III

PËRFITIMET

Neni 10

Përfitimet

- 10.1 Nga fondi i pensionit të "I.A.P.P.S.SH." paguhen:
- a) pensionet që rrjedhin nga skema e sigurimit të pensionit;
 - b) perfitimet e pagueshme në formën e shumave të menjehershme, shlyerjet, grantet, si dhe perfitime të tjera që rrjedhin nga kjo rregullore
- 10.2 Sipas përdorimit në këto rregulla, në pensione nuk përfshihet e ardhura nga sigurimi i detyrueshëm, vullnetar, suplementar shtetëror dhe pensioni shtetëror i posaçëm, që rregullohen sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligje të tjera në zbatim të tij.

Neni 11

Pensionet

- Pensionet që sigurohen nga IAPPSSH janë :
 1. *Pension pleqerie, i cili mund të jete:*
 - a. Pension pleqerie me afat të perhershëm
 - b. Pension pleqerie me kohë të përcaktuar
 2. *Pension për vjetërsi në punë*
 3. *Pension familjar*

Neni 12

Pensionet e pleqerisë

- 12.1 Pensioni suplementar i pleqerisë është lloj perfitimi suplementar në shtesë të atij që jepet nga ligji mbi sigurimin e detyrueshëm shoqëror.
- 12.2 I siguruari në kontratë mund të zgjedhë të përfitojë pension pleqerie të perhershëm ose pension pleqerie me kohë të përcaktuar.
- 12.3 *Pensioni i pleqerisë me afat të perhershëm* është lloj pensioni suplementar pleqerie që perfituesi përfiton përgjate gjithë jetës së tij, duke filluar nga momenti që i lind e drejta për të përfituar.
- 12.4 *Pensioni i pleqerisë me kohë të përcaktuar* është lloj pensioni suplementar pleqerie për të cilin perfituesi përcakton një shtrirje kohore gjatë së cilës ai do të përfitojë këtë pension.

Neni 13

Kushtet e përfitimit të pensionit të pleqerise

- 13.1 Çdo i siguruar në "I.A.P.P.S.SH.", kur heq dorë nga pjesëmarrja në skemën e fondit, ka të drejtën e përfitimit të pensionit të pleqerise pasi plotëson kushtet e mëposhtme:
- a) të ketë arritur kufirin e moshës 40 vjec për grate dhe 45 vjec për burrat
 - b) të ketë plotësuar minimalisht 5 vjet sigurim në "I.A.P.P.S.SH." dhe
 - c) të ketë ndërprerë/përfunduar pagesën e kontributeve.
- 13.2 Caktimi i përfitimit në çdo rast bëhet pas ushtrimit të kërkesës me shkrim nga përfituesi i ardhshëm. Levrimi i pensionit do të fillojë brenda 45 ditësh nga paraqitja e kërkesës.

Neni 14

Pensioni për vjetërsi në punë

Pensioni për vjetërsi në punë është lloj përfitimi suplementar, ku kusht i të qenit i përshtatshëm është arritja e një periudhe të caktuar sigurimi.

Neni 15

Kushtet e përfitimit të pensionit për vjetërsi në punë

- 15.1 Çdo i siguruar në "I.A.P.P.S.SH.", i cili në kontratë ka zgjedhur të përfitojë pension për vjetërsi në punë, ka të drejtën e përfitimit të pensionit pasi plotëson periudhën e sigurimit prej 180 muaj kalendarike.
- 15.2 Caktimi i përfitimit në çdo rast bëhet pas ushtrimit të kërkesës me shkrim nga përfituesi i ardhshëm. Levrimi i pensionit do të fillojë brenda 45 ditësh nga paraqitja e kërkesës.

Neni 16

Pensioni familjar

- 16.1 Pensioni familjar është lloj përfitimi suplementar ku kusht i të qenit i përshtatshëm për të përfituar është vdekja e personit të siguruar.
- 16.2 Pensioni familjar i sigurohet një personi fizik të përcaktuar nga i siguruari në kontratën e tij të sigurimit. I siguruari mund të përcaktojë me shumë se një person për këtë qëllim.
- 16.3 Pensioni familjar mund të paguhet personit fizik të përcaktuar në kontratë nga i siguruari, në madhësi të llogaritur se mbetur. Në përjashtim rasti kur i siguruari ka zgjedhur të përfitojë pension pleqerise të përherëshëm. Në këtë rast, pjesa e fondit që nuk arrin të mbulohet nga llogaria e tij do të mbulohet nga Siguruesi, me kusht që në rast vdekjeje të të siguruarit pa përfituar të gjithë pensionin, të zbritet një përqindje e caktuar nga madhësia e llogaritur që përfiton personi fizik i përcaktuar në kontratë

Neni 17

Menyra e llogaritjes se pensionit

- 17.1 Shuma e pensionit mujor që do të përfitojë çdo i siguruar në "I.A.P.P.S.SH.", do të jepet nga mjetet që gjenden në llogarinë e tij financiare në fund të periudhës së sigurimit, pasi i siguruari ushtron kërkesën për përfitim.
- 17.2 Periudha minimale e mbulimit me perfitime per cdo te siguruar do te jete jo me pak se pese vjet.
- 17.3 Në momentin që i siguruari vendos të dalë në pension, I.A.P.P.S.SH. bën llogaritjen e pensionit duke marrë ne konsiderate se:
- I siguruari përcakton se në sa vjet do që të tërheqë fondet e tij në formë pensioni, dhe shpeshësinë e tërheqjeve në një vit.
 - si normë interesi për llogaritjen e pensionit, do të merret mesatarja e portofolit të investimeve në momentin e llogaritjes së pensionit. Në fund të çdo viti, nga momenti i daljes në pension, do të bëhet rillogaritja e pensionit për vitin pasardhës, duke marrë për bazë normën mesatare të portofolit të investimeve.

Formula do të jetë

$$PMT = \left(PV + \frac{FV}{(1+ip)^N - 1} \right) X \frac{ip}{k}$$

- PMT (Payment) = Masa e pensionit mujor që përfiton i siguruari
- PV (Present Value) = Përfaqëson totalin e kontributeve + interesat deri në momentin e daljes në pension
- FV (Future Value) = Përfaqëson shumën që përfituesi dëshiron të mbetet në llogarinë e tij, pas përfundimit të pensionit të përcaktuar. (O në rast se nuk dëshiron të mbetet gjë).
- ip = është norma e interesit për periudhë. Ne rast se pensioni është mujor ip=normën e interesit vjetor/12.
- N = Numri i periudhave (Numri i viteve x 12) në rast se pensioni është mujor.
- K = 1 nëse pensioni tërhiqet në fund të periudhës; 1+ ip nëse pensioni tërhiqet në fillim të periudhës.

- 17.4 Personi i siguruar ka të drejtë të informohet në çdo kohë për evidencën personale të sigurimit nga fondi e pensionit.

- 17.5 Mbi bazën e rezultatit financiar të "I.A.P.P.S.SH." masa e pensionit mujor të çdo përfituesi mund të indeksohet çdo vit.
- 17.6 Këshilli Mbikëqyrës i "I.A.P.P.S.SH.", mund të vendosë indekse të ndryshme nga indeksi zyrtar i inflacionit në varësi të rezultatit financiar.

Neni 18

E drejta për përfitim nga fondi i pensionit

- 18.1 E drejta e përfitimit nga kjo skemë kërkohet në çdo kohë. Në çdo rast përfitimi do të paguhet që nga data e lindjes së të drejtës për te perfituar.
- 18.2 Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë.
- 18.3 E drejta e "I.A.P.P.S.SH." për të kërkuar shumat e marra tepër nga përfituesit, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit.
- 18.4 Personi, që ka përfituar të ardhura në mënyrë e mjete të padrejta, si edhe kur nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, përveç përgjegjësisë për shkeljen ligjore, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër.

Neni 19

Perfitimet e pagueshme ne formen e shumave te menjehershme

- 19.1 Ne rastet kur i siguruari permbush kushtet per pension dhe nderpret qendrimin e tij te perhershem ne Republiken e Shqiperise, ka te drejten e perfitimeve te pagueshme ne formen e shumave te menjehershme.
- 19.2 Dhenia e përfitimit nga IAPPSSH, në çdo rast bëhet pas ushtrimit të kërkesës me shkrim nga përfituesi 3 (tre) muaj perpara.

Neni 20

Grantet

- 20.1 Grantet u jepen të siguruarve me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të "I.A.P.P.S.SH." në rastet kur pas daljes së rezultatit financiar, fitimi i realizuar është më i lartë se parashikimi i bërë në planin buxhetor të "I.A.P.P.S.SH.". Masa e grantit që i jepet çdo të siguruari, llogaritet në përqindje, në përputhje me kontributin e paguar nga secili prej tyre
- 20.2 Grante mund t'u jepen edhe përfituesve në momentin që i fillon pagesa mujore e përfitimit. Këshilli Mbikëqyrës i "I.A.P.P.S.SH.", përcakton masën e grantit që jepet në këto raste.

Neni 21

Shlyerjet dhe përfitime të tjera

- 21.1 Shlyerjet jane procedura te kthimit te kontributeve te paguara nga te siguruarit ne kete skeme sigurimi, me kusht qe i siguruari :
- a) te kete perfunduar sigurimin e tij te pensioneve suplementare;
 - b) te kete paguar kontribute te pakten per 12 muaj kalendarike;

- c) te mos kete perfituar nga e drejta per pension;
 - d) kontributet e tij te mos jene transferuar ne nje institut tjeter pensionesh.
- 21.2 Shlyerja llogaritet si shumë e mjeteve të grumbulluara në llogarinë individuale të të sigurvearit si rezultat i pagesës periodike të kontributeve prej tij dhe investimit të tyre, të bërë nga “I.A.P.P.S.SH.”
- 21.3 Shlyerjet nga fondi i pensioneve, do të akordohen brenda 3 (tre) muajve nga data e kërkesës së ushtruar prej të sigurvearit që plotëson kushtet për shlyerje, apo personit fizik perfitues te percaktuar prej tij në rast se i siguruari ka vdekur.
- 21.4 Kur i siguruari, apo perfituesi tjeter (në rastet kur i siguruari ka vdekur), kërkojnë që shlyerja e mjeteve në llogarinë individuale të bëhet e menjëhershme, “I.A.P.P.S.SH.” mundëson shlyerjen e mjeteve të llogarisë individuale brenda një muaji nga data e kërkesës, duke zbritur nga kjo shumë një komision të barabartë me dëmin financiar që shkakton prekja e mjeteve të investuara.
- 21.5 Përfitime të tjera, mund të akordohen për të sigurvearit e fondit të pensioneve në formën e ndihmave materiale (kundravlefta), apo të pagesës së faturave (kundravlefta), për raste të fatkeqësive natyrore, apo të sëmundjeve të rënda (operacioneve dhe të tjera të kësaj natyre). Qe përcaktohen në çdo rast me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të “I.A.P.P.S.SH.”
- 21.6 Ne rastet kur i siguruari nuk percakton ne kontrate ndonje person fizik per te marre perfitimin ne rastin e vdekjes, ky perfitim do tu jepet trashegimtareve te tij sipas dispozitave te Kodit Civil mbi trashegimine.

Neni 22

Transferimi i kontributeve në një fond tjetër privat pensionesh suplementare

- 22.1 I siguruari ka te drejte te transferoje kontributet e tij se bashku me pjesen e tij te fitimit ne nje institut tjeter pensionesh ne keto kushte :
- a. pas nje viti nga krijimi i institutit ku eshte siguruar
 - b. pas tre vjet pagese kontributesh ne institut
- 22.2 I.A.P.P.S.SH eshte i detyruar te beje transferimin brenda 6 muajve nga data e paraqitjes se kerkeses nga i siguruari. Kjo kerkese duhet te shoqerohet nga marreveshja me institutin tjeter te pensioneve.
- 22.3 Ne kontraten e sigurimit mund te parashikohet edhe transferimi i kontributeve qe punedhenesi ka derdhur per sigurimin ne IAPPSSH.
- 22.4 Personi i siguruar qe ka plotesuar kushtet per pension suplementar nuk ka te drejte ti transferoje keto kontribute ne nje institut tjeter pensionesh Kur i siguruari kerkon qe transferimi i mjeteve te llogarise individuale te behet i menjehershem, ne nje tjeter institut privat pensionesh

Suplementare ,

Neni 23

Apelimi

- 23.1 Apelimi dhe kërkesat e refuzuara për përfitimet bëhen pranë Komisionit të Apelit.
- 23.2 Në rastet kur ankuesi nuk është dakord me këtë vendim, ankimi i drejtohet gjykatës nga e cila çështja zgjidhet përfundimisht.

PJESA IV

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 24

Pagesat nga fondi i pensionit për llogari të përfituesve

- 24.1 "I.A.P.P.S.SH.", hap llogaritë individuale për të gjithë personat e përfshirë në skemën e sigurimit në emër të tyre. Kalimi nga fondi i pensionit në llogaritë individuale të hapura të punonjësve përmban:
- a) pagim në shuma të përcaktuara të përfitimeve nga fondi i pensionit sipas përcaktimeve të nenit 3;
 - b) pagesa në përfitime të caktuara nga fondi i pensionit në proporcion me pagesat kontributive individuale të punonjësit.
- 24.2 Shumat e paguara nga punëdhënësi për llogari të punëmarrësve të tij të siguruar në "I.A.P.P.S.SH.", kontabilizohen në llogari individuale të ndara.

Neni 25

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë, dhe shfuqizon rregulloren e mëparshme.

K R Y E T A R I

I KESHILLIT MBIKEQYRES

Jeffrey T. Griffin